



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4271 prot.

Himarë, më 12.06 . 2026

VENDIM

Nr. 34 , Datë 04/06 /2026

PËR

“DHËNIEN E MIRATIMIT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PËR NJË AFAT 3 (TRE) VJEÇAR, NGA FONDI PYJOR KULLOSOR TË NJË SIPËRFAQE PREJ 0.79 HA NË EKONOMINË PYJORE “FAJEO”, NGA STRA NR.1, ZK:2863 NË FAVOR TË SHOQËRISË “ERAL CONSTRUCTION” SH.P.K.

AKTIVITETI:

“VENDOSJE KANTIERI DHE DEPOZITIM I MATERIALE INERTE SI PIKË TRANZITI”

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe neni 54; VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, ligjin nr.57/2020, “Për Pyjet”, neni 5; VKM-në nr. 592, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në VKM nr.1354, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”; VKM-në nr.888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit , procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, VKM-në nr. 559 ,datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim /përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike”. Me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Himarë, Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 04.06.2026, miratoi me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit për dhënie në përdorim për një afat 3 (tre) vjeçar, nga fondi pyjor kullor të një sipërfaqe prej 0.79 ha në ekonominë pyjore “fajeo”, nga str. nr.1, zk:2863 në favor të shoqërisë “ERAL CONSTRUCTION” për aktivitetin “VENDOSJE KANTIERI DHE DEPOZITIM I MATERIALE INERTE SI PIKË TRANZITI”.

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë dhe administrata, për përgatitjen dhe nënshkrimin e kontratës “Për dhënien në përdorim për një afat 3 (tre) vjeçar, nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 0.79 ha në ekonominë pyjore “fajeo”, ngastra nr.1, zk:2863 në favor të shoqërisë “ERAL CONSTRUCTION” për aktivitetin “VENDOSJE KANTIERI DHE DEPOZITIM I MATERIALE INERTE SI PIKË TRANZITI”.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar ne ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

